



Trajneri i Flamurtarit Ernest Gjoka ishte shume i pakenaqur nga gjykimi i kryesorit Kridens Meta i cili sipas trajnerit mik u paraqit i njeheshem ne vendimet e tij gjate gjykimit te ndeshjes Kastrioti-Flamurtari. "Ishte nje ndeshje e veshtire aq me teper ku perballe ke nje skuader qe lufton ti shpetoj fundit te tableles. Futbollistet e Flamurtarit treguan karakter ne fushen e lojes. Mund te kishim marre me shume se nje pike nese gjyqtari duhej te ishte treguar me korrekt me vendimiet e tije. Ndaj Kastriotit na u mohuan jo pak por dy penallti. Sikur te jepte te paketn njerien nga penalltite, loja do te kshte tjeter rrjedhe. Tashme cdo ndeshje duhet te konsiderohej finale me vete", perfundoi Gjoka i pakenaqur.